Aktualitet

Sherri në Berat ku u plagos efektivi i policisë, flet nëna e njërit prej të përfshirëve: Ishin të pirë, na thanë pse shikoni nga shtëpia jonë! Tre vëllezërit e arrestuar: S'mbajmë mend ç'kemi bërë

Tre vëllezërit në Berat, që u përfshinë në një sherr mbrëmjen e djeshme ku mbeti i plagosur edhe një efektiv policie, janë arrestuar ndërsa është shpallur në kërkim edhe vëllai tjetër.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
15 Prill, 10:48 | Përditesimi i fundit: 15 Prill, 13:59

Share

Tre vëllezërit në Berat, që u përfshinë në një sherr mbrëmjen e djeshme ku mbeti i plagosur edhe një efektiv policie, janë arrestuar ndërsa është shpallur në kërkim edhe vëllai tjetër. Janë prangosur Gerald Marini 38 vjeç, Marjus Marini 42 vjeç dhe Arjan Marini 40 vjeç, ndërsa është shpallur në kërkim Armando Marini 46 vjec.

Shkëndi Memaj, e ëma e Albert Memaj që u përfshi në sherrin me katër vëllezër mbrëmjen e djeshme në Berat, ka treguar se katër vëllezërit i kanë ndihmuar sa herë kishin nevojë dhe se nuk kanë patur konflikte të mëparshme, por dje kishin shkuar të dehur në dyqanin e tyre. Sipas saj, vëllezërit u konfliktuan me Albert Memaj për motive banale, duke i thënë se pse mbani njerëz në dyqan dhe pse shikonin nga banesa e tyre.



LEXO EDHE:
Rama nga Berati: Shqipëria kampione e eksporteve bujqësore në rajon, gati paketën me 10 mld euro, më e madhja e investimeve në ekonomi

Ndërkohë, para policisë, tre vëllezërit e arrestuar kanë thënë se kanë qenë të pirë dhe se nuk mbanin mend se çfarë kishin bërë një natë më parë.

Konflikti u regjistrua mbrëmjen e djeshme, ku u përfshinë katër vëllezërit (përdorues të lëndëve narkotike) me komshinjtë e tyre Albert Memaj dhe bashkëshorten e tij Olta, ku këta 2 të fundit kanë mbetur të lënduar me gurë.

I plagosur mbeti edhe efektiv i policisë Julian Xhelilaj, 20 vjeç, i cili ndërhyri për të qetësuar situatën, por katër vëllezërit tentuan t'i merrnin armën dhe gjatë konfrontimit, arma iu shkrep në brez, duke bërë që polici të marrë një plumb në këmbë.

Ai u transportua për në Spitalin e Traumës Tiranë, për ndihmë mjekësore më të specializuar.

Share

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:04

Sherri mes dy familjeve në Berat ku u plagos efektivi i policisë, flet nëna e njërit prej të përfshirëve: Erdhën në dyqan të pirë, na thanë pse shikoni nga shtëpia jonë

Shkëndi Memaj, e ëma e Albert Memaj që u përfshi në sherrin me katër vëllezër mbrëmjen e djeshme në Berat, ka rrëfyer se si ndodhi ngjarja. Ajo thotë se katër vëllezërit i kanë ndihmuar sa herë kishin nevojë dhe se nuk kanë patur konflikte të mëparshme, por dje kishin shkuar të dehur në dyqanin e tyre. Sipas saj, vëllezërit u konfliktuan me Albert Memaj për motive banale, duke i thënë se pse mbanin njerëz në dyqan dhe pse shikonin nga banesa e tyre.

> *"Në fillim shkojnë dy vëllezërit Marini dhe konfliktohen me djalin e kapin prej fyti dhe djali largohet duke hyrë brenda në shtëpi. Ata filluan të gjuanin me gurë në banesën tonë. Nga gurët u plagos nusja e djalit në kokë dhe i them djalit të marri policinë se na vranë. Më pas vjen policia dhe hynë për të ndarë konfliktin duke i ndaluar vëllezërit që po qëllonin me gurë. Gjatë shoqërimit për në polici të vëllezërve Marini aty kanë kundërshtuar dhe kane tentuar që t'i merrnin dhe armën policit ku ndodhi dhe plagosja e policit. Nusen me djalin erdhi i mori ambulanca sepse kishte shumë rrjedhje gjaku. Ne nuk kemi gjë me komshinjtë ata ishin të pirë prandaj u konfliktuam", është shprehur ajo.*

Ngjarja ndodhi mbrëmë në lagjen "Dëshmorët e Kombit", ku Albert Memaj dhe bashkëshortja e tij Olta Memaj, u konfliktuan me katër vëllezërit Gerald Marini 38 vjeç, Marjus Marini 42 vjeç, të cilët janë arrestuar dhe Arjan Marini 40 vjeç, që është shpallur në kërkim. Si pasojë e konfliktit ka mbetur i plagosur efektivi i policisë Julian Xhelilaj, 20 vjeç, i cili ndërhyri për të qetësuar situatën, por katër vëllezërit tentuan t'i merrnin armën dhe gjatë konfrontimit, arma iu shkrep në brez, duke bërë që polici të marrë një plumb në këmbë.

Share

J.SH./b.ha./Shqiptarja.com

TAG: sherr | berat | Gerald Marini | Marjus Marini | Arjan Marini | Armando Marini | Albert Memaj | olta memaj

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A është i pranueshëm për ju përdorimi i të dhënave personale nga një parti politike?

Po | Jo | Nuk kam mendim

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

Nënkryetari i FRD-së ngacmon seksualisht vajzën dhe i premton punë pas zgjedhjeve: 500 mijë lekë e hajde futu! Po u bërë e dashura ime do bëhesh drejtoreshë
20 Prill, 21:35

Aktualitet

Situata nga pandemia, Manastirliu: Që nga fillimi i pandemisë janë kryer gjithsej 350 mijë vaksinime
20 Prill, 20:32

Aktualitet

Sulmi me thikë në xhami, rrëfehet për Report Tv shoku i fëmijërisë së autorit: Rudolfi s'pinte ilaçet, ngjarja s'ka lidhje me radikalizëm, ishte e momentit
20 Prill, 20:03

Aktualitet

Kryetarja e KPA-së pret në takim ambasadorin e OSBE-së në Tiranë
20 Prill, 19:43

Aktualitet

Po tentonin të trafikonin 30 kg kanabis, arrestohen në flagrancë 4 persona në Malësinë e Madhe! U gjendet edhe një armë zjarri
20 Prill, 18:53

Aktualitet

Aksident në dalje të Lezhës, plagosen rëndë dy qytetarë! Shoqërohet në polici drejtuesi i njërit prej mjeteve
20 Prill, 18:26

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje